



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 23-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 29.11.2019 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Muhamet Ukaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 19. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 22. Labinot Aliaj, PDK; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Riza Dreshaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Ruzhdi Metaj, LDK; | 25. Radoš Repanović, SL; |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Misin Berisha, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 14. Nexhmedin Balaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Nënkryetari Agim Ademaj, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z.Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit dhe lidhur me rastin e fundit që ndodhi në Shqipëri, si pasojë e tërmetit që goditi Durrësin dhe Thumanën nga rrenojat e objekteve të demtuara pati humbje të jetës së njerëzve dhe shumë të lënduar të tjerë, kërkoi që të mbahet një minutë heshtje. Pastaj hapi punimet për mbledhjen e 23-të të rregullt të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020 si dhe orarit për mbajtjen e takimeve të KK-së dhe KPF-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022;
6. Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba dhe
7. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, atëherë kush është që të miratohet ky rend i ditës për këtë mbledhje? Fjalën e ka kërkuar Arif Elshani?

Arif Elshani, unë propozoj që si pikë të rendit të ditës, nëse ne si kuvend komunal organizojmë marrim ndonjë iniciative që të mbledhim disa ndihma dhe të shkojë kjo ndihmë në mënyrë institucionale. Unë mendoj që kjo të jetë pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi, lidhur me këtë çështje kemi biseduar dhe kemi mendu se është pak herët që të vendoset. Sigurisht që e kemi vullnetin që këtë të bëjmë dhe do të shohim nëse është nevoja do të thërrasim një mbledhje të jashtëzakonshme për këtë pikë dhe do të analizojmë më mirë. Nuk i kemi ikur kësaj pikë të rendit të ditës.

Agim Ademaj, unë nuk kam çka të shtoj më shumë, është shumë e vërtetë që do të këtë nevojë për ndihma. Në formë të ndryshme është bërë një ndihmë por ka rrëime të mëdha dhe sigurisht ka nevojë për ndihmë financiare. Nëse është e nevojshme atëherë në do të thërrasim një mbledhje të jashtëzakonshme dhe do të vendosim.

Kuvendi në mënyrë unanime, miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje, pa ndryshime.

Në procedurën e votimit nuk mori pjesë: Jehonë Haxhijaj

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje nuk mungon askush. Gjithsej në mbledhje ishin të pranishëm 27 (njëzetë e shtatë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Jehonë Haxhijaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020. Këtë rregullore e kemi aprovuar edhe vitin e kaluar. Fjalën ja kaloi drejtorit Hysni Maxharri.

Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi projekt-Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020.

Kryesuesi, te nderuar anëtar të kuvendit ju përcjellë fjalën juve.

Arben Kabashi, përshëndeti të pranishmit, unë kam pyetje për zonat tatimore. A kemi ngritje në tarifa krahasuar me rregulloren e vitit të kaluar për shkak se e kemi për vitin 2020? Dhe a mund të specifikosh saktë se ku kemi rritje të shumave për metër katror të zonave tatimore?

Mirushe Sadikaj, desha me cek, në këtë rregullore ku është kategoria për prona? Pse nuk është përfshire prona rezidenciale? Ndërsa të kategoritë për prona, norma tatimore është përfshi?

Hysni Mazharri, pyetja e Arbenit, po i përgjigjem se nuk ka asnjë ndryshim. Janë norma të njëjta sikurse edhe të rregullorja e vitit të kaluar. Pyetja e Mirushes që e beri, atëherë në si komunë vetëm të neni 4, të norma tatimore mund të propozojmë dhe të ndryshojmë. Të gjitha këto të tjera vijnë nga ministria përkatëse.

Agron Avdijaj, unë desha të ndërlihem sepse kam mar një pyetje nga qytetarët kur është çështja të tatimi në pronë dhe nuk paguhet. Ndërkohën më dënim edhe me

kamatën e vonesës. Tash nuk po e di a është kjo e paraparë me ligj apo mundet komuna me vendos me bërë njërën?

Hysni Maxharri, kjo është e parapare më ligj, është shuma e tatimit, gjoba dhe interesi.

Naim Behlulaj, përshëndeti të pranishmit. Një pyetje sa i përket pjesë Uçës, është ndare në dy pjesë. Nuk po e kuptoj pse janë ndare dy zona.

Hysni Maxharri, Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë, ka bërë raportin e vlerësimit të përgjithshëm për objektet rezidenciale për komunën e Istogut dhe e ka dorëzuar raportin, në bazë të atyre zonave është ndarë Uça, Studenica e të tjera.

Kuvendi me 25 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi projekt-Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020 si dhe orarit për mbajtjen e takimeve të KK-së dhe KPF-së. Në takimin e kaluar ne e kemi mar një vendim për formimin e Grupit punues për hartimin e këtij plani. Grupi punues është mbledhur dhe ka përgatitur këtë plan. Ka kaluar edhe në KPF, mbledhjen e fundit. Plani është një draft për momentin e që do të aprovohet por që nuk është i pandryshueshëm. Ju kërkoj falje që e keni mar me vonesë planin dhe po ashtu sot ju është dërguar kalendari i takimeve. Nëse nuk dëshiron askush fjalën atëherë kush është që të miratohet Plani vjetor i punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020 si dhe orarit për mbajtjen e takimeve të KK-së dhe KPF-së?

Kuvendi me 25 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi i Planin vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020 si dhe orarin për mbajtjen e takimeve të KK-së dhe KPF-së.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022. Unë për këtë pikë nuk kam çka të flas përveç se kemi marrur një shkresë nga

ministria që t'i aprovojmë këtë plan në kuvend sa më shpejt që është e mundur. Fjalën ja kaloi Muhamet Gusturanit, Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian.

Muhamet Gusturani, përshëndeti të pranishmit. Prezantoi Draft-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022.

Kuvendi me votim 23 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Draft-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Zenel Shatri dhe Riza Dreshaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Edhe kjo është një rregullore që kërkohet nga ligji, statuti pra nga aktet normative. Kjo rregullore është punuar nga komisioni si draft dhe do t'i kalojë procedurat e nevojshme dhe pastaj vjen për miratim. Nëse nuk keni diçka për këtë projekt-rregullore, kush është që të përcillet për dëgjim për qytetarë?

Kuvendi me votim 23 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime shpall në diskutim publik Projekt-Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Zenel Shatri dhe Riza Dreshaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e kuvendit komunal. Pyetje me shkrim nuk kemi, fjalën e ka kërkuar Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit, përveç atyre që i kam bërë me shkrim e kam edhe një çështje për siguri në bashkësi në fshatin tim Staradran. Qentë endacak janë problem shumë i madh, qysh është puna a janë sistemu dikun, a i ka lëshu dikush? Janë shumë të rrezikuara po flas për fshat timin e sigurisht janë edhe në fshatra tjera përreth. Po ashtu kisha pas dëshirë më diskutu edhe për çështjet e punësimit, konkurset për punësim që me i shiku pak me rend, si komunat tjera që janë duke i bërë, këtë po e dhe si propozim.

Agron Avdijaj, atëherë unë i kam tri pyetje. Po fillojë me Drejtorinë e Arsimit, me sa di unë Këshilli drejtues i shkollës së Gjimnazit "Haxhi Zeka" e ka bërë një kërkesë për krijimin e një Komisioni disiplinor për disa telashe që po ndodhin aty. Nuk e di a është krijuar nëse po, ku është procesi i asaj?

Po ashtu kam marr shqetësime të cilat i ka përmend edhe Ajshja më herët, rreth çështjes se pagës jubilarë por jo vetëm tek sektori i arsimit por edhe të sektorit të shëndetësisë. Sipas informacioneve që me kanë dhënë njerëzit, kanë fillu me i dorëzuar kërkesat dhe ankesat e tyre edhe përmes padive dhe përmbaruesve. Unë konsideroj që ata kanë bazë ligjore pastaj dhe përmes përmbarimit mi tërheq pagat jubilarë, e që kjo ka me e rrit koston për komunën e Istogut. Prandaj kisha dasht me ditë ku është ky proces dhe a ka ndërmarrë diçka konkrete komuna për këtë rast? Po ashtu i kam edhe disa shqetësime sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike është fjala kur po ndodhin intervenime, sanime ku kemi rastin konkret që ka ndodhë në Stupe nuk po përmirësohet menjëherë, ajo baza po fillojnë ato gropimet po vazhdojnë. Po ashtu kemi edhe rrugë tjera që zgjasin deri një vit, kjo në Stupe është aktuale por banorët janë të shqetësuar me këtë, çka mundet drejtoria me ndërmarrë më shpejtë se kur të bëhet një intervenim sanimi pas, për shembull është zgjedh problemi i ujit mirëpo është mbetë e gropume edhe një ditë në kohë të shirave, ka me qenë telashe edhe nuk rregullohen ato.

Labinot Aliaj, përshëndeti të pranishmit, unë e kam një pyetje për drejtorin e Inpektoriatit, muaj më parë e kemi votuar një rregullore për orarët e punës. Nëse kishe mund me sqaru deri ku kemi shku me atë rregullore, a ka fillu implementimi i asaj ende edhe a janë njoftuar biznesët që në dyert të lokaleve të vendoset orari i punës? Se po e shohë që është shumë e mangët kjo. E kam edhe një kërkesë te faqja zyrtare e komunës të përfshihem edhe ne asamblesitat që jemi ardh pak më vonë, se qysh e pash nuk ishim askund.

Kryesuesi, po mund shkosh tek zyrtarja për informim dhe ta bësh një fotografi, unë e kam bërë këtë kërkesë por nuk e di deri ku kemi shkuar me këtë procedurë, besoj që përgjigjen për këtë pyetje e more tani.

Hajrush Shoshi, përshëndeti të pranishmit. Unë i kam dy pyetje një nga znj. Ajshe ku diskutohet rreth çështjes se pagave jubilarë. Unë kam thënë edhe një here se pagat jubilarë janë çështje e Qeverisë. Qeveria vendos për ato paga, në vitin e kaluar i kemi dorëzuar listat me tri pagat shtesë, këtë vit paghuhet tri paga shtesë. Ndërsa për këtë vit po presim që do të dalin në buxhet edhe pagat jubilarë. Ndërsa sa i përket komisionit diciplinor që tha Agroni, ne e kemi një kërkesë dhe ajo është në procedurë dhe besoj që shumë shpejt do të formohet komisioni dhe të merrën masat.

Kryesuesi, veç një gjë deshta me cek, të dimë ta bëjmë dallim rreth pagës jubilarë dhe tri pagave shtesë pas pensionimit, Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj, ne e kemi paraqit këtë çështje me herët edhe unë drejtorit të Drejtorisë së Arsimit i kam thënë se duhesh me i planifiku meqënëse komunat përrreth i kanë marrë edhe të gjitha buxhetin e marrin prej ministrisë kryesore qendrore. Ne nuk mundemi me qenë të anashkaluar, për shembull Klinës edhe komunave tjera ju kanë taku. Pse munda jonë mos me u shpërbly? Mu ma merr mendja që Qeveria i ndan mjetet, ne i planifikojmë. Edhe drejtori e din fort mirë se unë i kam thanë, drejtor të lutem këto kanë shku por planifiko për këtë vit se pagar jubilarë ne duhet me i

marrë. Edhe drejtori ka thanë se i ka planifiku. Tash qka është përzi çështja e tri pagave mbas pensionit me çështjen e pagave jubilarë, këto nuk kanë të bëjnë asnjëra me tjetrën. Këto dallojnë dukshëm njëra prej tjetrës, unë për veti nuk jam e kënaqur me përgjigje.

Agron Avdijaj, pata edhe një plotësim që me pas parasysh komuna se ka fillu interesimi i këtyre pra edhe për paga jubilarë edhe për këto pagat tjera sipas përvojës së punës që i kanë. Edhe gjitha këto kërkohen pastaj përmes padive dhe përmes përmbaruesve. Unë konsideroj që e kanë bazën ligjore ku ja marrin komunës këto mjete pastaj pamvarsisht a i keni të planifikume a jo. Tani e thirrja ime është që ndërmerrni diçka hapa çka mundeni të bëni më shpejt lidhur me këtë, që mos me ardh pastaj përmbaruesi me ju konfisku, paret buxhet e nuk patet.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit, unë dashta ndërlidhem me pagat jubilarë. Sa e mora vesh drejtori tha që paguhen prej këti viti, çka do të bëhet me ato paga që kanë qenë para këtij viti? Unë e ndaj shqetësimin edhe të Agronit sepse edhe unë i di disa njerëz që e kanë fitu këtë edhe përmes përmbaruesve. Kështu që kisha rekomandu që të keni kujdes mos të dëmtohet buxheti i komunës për shkak të neglizhencës të komunës tonë. Nëse ju takon tu japim mos të shkojnë përmes formave tjera.

Hajrush Shoshi, çështja është si duket për tri paga shtesë edhe për pagat jubilarë për vitin 2015-2018. Këto katër vite ne nuk kemi drejt me ju pagu as pagat jubilarë as shtesat dhe të gjithë po shkojnë përmes përmbaruesve. Ne i kemi vendimet për të cilat nuk kemi mjete. Nuk kemi të drejtë me i ndarë ato mjete, nuk kemi drejtë me i pagu sepse nuk kemi ligj, nuk kemi rregullore. Nuk e kan përcjell, ajo kontrata kolektive është nënshkruar mirëpo në ministri të financave nuk është përcjell asgjë. Këto i kanë paguar disa komuna me përmbarues. Klina i ka pagu me përmbarues mirëpo ata e kanë bërë një marrëveshje përmbarimore do të thotë me të gjithë ata që kanë pas kërkesa të mësimdhënësve. Edhe vitin e kaluar ju kanë paguar një pjesë por me përmbarues. Edhe ne këtë vit kemi me përmbaru, tash na kanë marrë 4.200 euro një përmbarim andaj nuk jemi ne fajtor, nuk kemi asnjë mundësi tjetër.

Hysni Maxharraj, vetëm një plotësim të vogël, të gjithë ata që kanë dalur në pension do të thot janë larguar prej listës së pagave dhe nuk ka shanc që të kthehen e të futen në listë të pagave. Pa qenë në listë të pagave edhe me i pasur mjetet edhe me pas buxhetin nuk kemi qysh me i bërë pagesat.

Naim Behlulaj, mirë unë e kuptova drejtorin për katër vitet e kaluara nuk ka rregullore për me i pagu por çka do të ndodhë me 2019-en? A do të paguhen pagat jubilarë dhe kur, a ka mjete?

Hajrush Shoshi, unë thash që për 2019 janë pagu tri pagat shtesë ndërsa për pagat jubilarë i kanë listat dhe informacionet ministria. A do të futen për 2020 në buxhet ajo nuk varet prej neve, nuk është çështje komunale është qendrore.

Ajshe Metaj, unë e thash edhe një herë, çështja kur e citova me herët që prej buxhetit vijnë të gjitha. Në buxhet qendror ne i kemi të gjithë hiset e barabarta sipas meritave sipas numrit të banorëve e gjithë të punësuarve çka i kemi. Pse mos me qenë pune e jona kjo, pa i kërku senet tona ne nuk na i jep askush. Ne kemi kërkuar që të planifikohen, është planifiku pse nuk janë paguar?

Enver Rugova, përshëndeti të pranishmit, sa i përket pyetjes së parë po filloj me kolegen, profesoreshën e nderume. Çështja e qenëve endacak është bërë problem edhe kombëtarë. Në vitin 2018 Qeveria e Kosovës i ka ndarë një milion e treqindë mijë euro edhe i ka ndarë parimisht AVUK-u nëpër regjione. Kështu që në Regjonin e Pejës e kanë fitu tenderin dy kompani që t'i kryejn ato procedura për eliminimin e tyre. Me keqardhje muj me ju thënë që Sektori i emergjencave pranë drejtorisë së Shërbimeve Publike të komunës së Istogut, intenzivisht kanë komunikuar me ato kompani edhe muj me than që është një përceptim qesharak i atyre kompanive. Sjellni ata numrat në vesh që i kanë qentë edhe ne vijmë e i zëmë. Asi soji kemi pas përgjigje prej atyre dy kompanive, ne nuk kemi pasur mjete buxhetore për me i ndarë të planifikume, të pa planifikuara nuk na kanë lejuar. Ka qenë edhe si urdhër i qeverisë së mëparshme tash po vjen qeveria e re e ishalla na lejojnë e për vitin e ardhshëm na lejojnë prej emergjencave do t'i ndajmë mjetet edhe do t'i alokojm. Por është e kotë besomni nëse një komunë punohet në atë drejtim mirë, kur i sjellin prej regjioneve tjera edhe kanë ndodhë raste kur Policia e Kosovës, kur i ka kap ata keqbërësa, që i kanë sjellë nëpër komuna tjera nuk po them që vetëm në Istog por i kanë dërgu prej regjioni në regjion edhe i kanë paraqit si storie suksesi. Sa i përket pyetjes së z.Avdijaj kjo po ndodhë siç e dini prej vitit të kaluar. Që trembëdhjetë muaj, dy kompani për mirëmbajtjen e rrugëve verore dimrore të asfatuara patën ofertu, kanë qenë në OSHP, ankesë pas ankese deri tani. Është nënshkruar kontrata tani e tutje do të sanohen në vazhdimsi edhe ato intervenimet e Hidrodrinit. Ata nuk kanë qare pa intervenu se po ka plasaritje, po ka gypa të vjetruar po ka hala gypa të azbestit, që jemi në procedura të heqjes së tyre. Mirëpo kur te jep lejen drejtorja e Shërbimeve publike që paraqitet leja për me pre asfaltin ose me dëmtu trotuarin ose diçka prej infrastruktures publike, jemi të detyrar me i sanu. Në ato vende ku nuk e kemi dhënë ne pelqimin ose lejen për me i dëmtu infrastrukturen, pastaj ne t'i rregullojm, meret Policia e Kosovës, që ne jemi në proces pasi që na e kanë bërë kërkesen policia që ne tu japim atyre sepse ka edhe prerje të egra. Çka janë të Hidrodrinit dhe lejet tona i kryen komuna tash me kontraten e re që e kemi me kompani. Kurse ato të egrat do të meret Policia e Kosovës, sigurisht ne i rregullojmë pastaj por do të jetë një padi nga ana e policisë një kundërvajtje.

Naim Behlulaj, një pyetje ja kisha bërë drejtorit të Shëndetësisë, kemi ankesa prej qytetarëve sidomos prej të moshuarve për mungesë të vaksinave kundër virusit dimëror sezonal. A ki njohuri kur do të vin ato vaksina edhe të këto shtëpijat e shëndetit. Këta dy muaj ka mungesë terapive sidomos të këtyre me diabet do ditë ka qenë më mirë e tash ka mungesë shumë, a ka mundësi që mu furnizu këto shtëpi të shëndetit apo ku është problemi?

Mujë Osmanaj, përshëndeti të pranishmit, pyetja për vaksina është fakt që janë vanu për shkak se ministria sipas rregullores nuk i ka sjellë. Ne kemi kërku deri në fund të nëntorit e fundi i nëntorit është ky, në mengjes e telefonova doktoreshën që është përgjegjëse për këto dhe është në kontakt vazhdimisht për këto çështje edhe ajo tha që po presim javën e ardhëshme. Unë shpresoj që do të vin edhe ashtu jemi me vonesë. Ju keni pa që nuk ka në treg as privat as shtetërorë. Sa i përket barnave të këtyre ne kemi investu si komunë rreth 40.000 mijë euro shtesë jashtë asaj liste që e kemi dhe që është e paraparë për një vit. Edhe si komunës edhe si drejtorat për Shëndetësi 40.000 euro janë shtesë për barna dhe materiale të tjera, që kanë qenë të nevojshme. Sepse prej korrikut dikun në fund të qershorit kanë ardhë ma pak është vrejtur në depo të farmacive. Ndërsa ne kemi intervenu dhe ja kemi dal dhe po ja dalim por ndoshta ka mungesë në tableta ndoshta por nuk mundemi me shkru që duhet me ble tableta por insolina, ambullare çdo gjë që duhet për infuzione për gjitha të tjera jemi mirë.

Demë Çeta, përshëndeti të pranishmit, sa i përket orarit të punës tash është sezona dimrore për sezonë verore kemi pa marr një vendim këtu si kuvend dhe na ka dal shumë telashe për vazhdimin orarit të këtyre lokaleve, që me duket ka qen propozim i Labinotit. Edhe nuk na kanë kthi përgjegje kurrë, a është valide, a nuk është valide? Por përderisa ky kuvend ka marr kësi vendimi atëhere ne e kemi respektu këtë vendim. Ndërsa tash për sezonën e dimrit lokalet e dinë në varet prej veprimtarisë së tyre, orarin e din dhe duhet ta respektojnë. Kryesisht po i repsketojm se ne nuk jemi gjithë natën aktiv mirëpo policia po i kontrollojnë dhe po i përcjell. Ka nga pak tejkallime por ata që kanë tejkallime të punës policia le të vjen na informon edhe disa lokale kanë marr gjoba, të cilët nuk e kanë respektuar orarin e punës.

Kryesuesi, Lavdiye Bujupi e ka pasur një pyetje nga mbledhja e kaluar për çështjen e kompleksit që gjendet në qender të Istogut ish-pronë e Korenikut më vonë e menaxhuar nga AKP-ja, nga ky kuvend patëm kërkuar që ajo pjesë të mbetet interes i komunës dhe çka ka ndodhë? Unë lidhur me këtë përgjigjefjalën ja kaloj drejtorit të Drejtoratit për Urbanizëm ose drejtori i Drejtoratit të Inspektionit.

Besart Dreshaj, përshëndeti të pranishmit, Lavdiye pyetjes që ju ke adresu, ne menjëherë jemi marr me procedura dhe ju kemi drejtu ministris përkatëse, ministria përkatëse ju ka drejtu qeverisë. Dhe qeveria e ka nxerr vendimin me datën 07/05/2019 që ky objekt është miratuar për tu rrenu dhe në bazë të kërkesës së komunës së Istogut kanë përfunduar të gjitha procedurat. Tash ka mbet vetëm Ministria e Financave me bërë vlerësimin e shpronsimit të tri banesave të cilat gjinden në katin e sipërm, që me metra katror ishin diku rreth 49 metra katror. Çka punohet tek punohet tash e mer fjalën Dema?

Demë Çeta, dikush prej atyre prej pronarëve aty i ka ndrru disa tjegulla dhe nuk e kemi pengu meqenëse aty ka fillu me pik. Dhe ato tjegulla kanë mujt me ra prej aty ku ka mundur edhe dikend prej kalimtarëve me mbyt krejt. Kemi mendu që ajo nuk mundet me ja ndrru vlerën prandaj e kemi toleru.

Besart Dreshaj, Ajshe në mungesë të drejtorit Lulzim Blakaj, Inkupatori i biznesit në Shtëpinë e Kulturës domëthënë asambleja komunale në vitin 2016 e ka nxerr një llojë vendimi për me nis me procedura për themelimin apo për shpalljen e katit të dytë të Shtëpisë së Kulturës si Inkupator i biznesit. Ministria e Tregtisë e ka mbështet me një fond diku rreth 120.000 mijë euro, mirëpo për ta licensuar apo të jepet si zyrtarisht si inkupator i biznesit ne duhet të vazhdojm me procedura me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sepse është kompetencë, e cila i dedikohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Do të thotë jemi duke punuar në atë drejtim por jo vetëm aty tek Inkupatori i biznesit por te Shtëpia e Kulturës është pak problem edhe qatija. Kështuqë kur të renovohet përfundon komplet edhe kati i dytë i leshohet dhe i dedikohet komplet Inkupatorit të biznesit. Këto mjete që janë ndarë është rregulluar infrastruktura e mbrendshme.

Kryesuesi, edhe një pyetje e kemi pasur nga Naim Behlulaj lidhur me grumbullimin e mbeturinave.

Enver Rugova, Naimi ka të drejtë që ka parashtuar atë pyetje. Tani kompania nga dita e diel fillon me grumbullimin e mbeturinave në disa lagje, që nuk i ka pasur nga ana e Lubozhdës, Prigodë, Januzaj. Për anën e mbivades është bërë maksimumi deri aty ku jemi ardhur, pa e siguru edhe një kamion nuk ka asgjë. Besoj që në prill, Ambasada e Japonisë e ka ndarë një fond për me porositë kamionin por duhet të presim deri pas 31 marsit dhe kamioni do vijë i ri dhe do të ju dedikohet asaj pjesë.

Labiotot Aliaj, desha të falënderoj Nënkrjetarin që zotimin e herës kaluar e mbajti dhe drejtorat qendruan këtu.

Kryesuesi, duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim dhe kontributin e dhënë i shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 11:30.

Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj



Kryesues,
z. Qaush Balaj